



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Në çështjen juridike të:

AC-II-15-0027

1. **Sh. Xh**
2. **R. Xh**
3. **R.1 Xh**
4. **S. Xh**, dhe
5. **Xh. R** Prizren.

Paditësit

Të gjithë të p, a.. Prizren.

Kundër:

E paditura/Ankueset

1. **NSH. KBI, “P-L-B” Prizren,**
2. **Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr. “Agim Ramadani” nr.23, Prishtinë.**

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Ilmi Bajrami, gjyqtar kryesues, Sabri Halili dhe Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesat e të paditurave të parashtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale, Prizren, C.nr.326/2001 të datës 19/01/2011, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 16/07/2020 lëshon këtë:

A K T V E N D I M

1. Ankesat e të paditurave janë të bazuara.
2. Anullohet, Aktgjykimi i Gjykatës Komunale, Prizren, C.nr.326/2001 i datës 19/01/2011.
3. Padia dërgohet për rigjykim në shkallë të parë të DHPGJS-së.
4. Nuk caktohen taksa gjyqësore për këtë procedurë ankimore.

Rrethanat faktike dhe procedurale:

Me datë 08.06.2001, paditësit, Sh. Xh , R. Xh, R1 Xh dhe S Xh, të gjithë nga fshati Skorobishtë, Prizren, e dorëzuan një padi për kthimin e patundshmërisë në Gjykatën Komunale në Prizren. Ata pohuan se janë trashëgimtarë legal të ndjerit A. Xh nga, Prizren, i cili ka qenë pronarë i patundshmërisë të evidentuar si ngastër kadastrale nr. 568/2, në vendin e quajtur “R”, arë e klasës së III-të, në sipërfaqe prej 0.10,18 ha, dhe ngastrës kadastrale 571/2 në vendin e quajtur “R ispod izvora”, arë e klasës së IV, me sipërfaqe prej 0.18,14 ha, të evidentuara sipas listës poseduese nr. 561 KK, L (me tutje prona kontestuese). Paditësit si trashëgimtar ligjor të paraardhësit të tyre A. Xh kërkuan nga Gjykatat njohjen e të drejtës pronësore, dorëzimin në posedim, regjistrimin në librat kadastral të pronës kontestuese në emër të tyre në bazë të Aktgjykimit të Gjykatës Komunale, Prizren, P.nr.471/94 të datës 13/02/1997 me klauzolë të plotfuqishmërisë të datës 25/04/1997 ishte vërtetuar se është e pa vlefshme ,Nul kontrata mbi shit-blerjen e patundshmërisë të lidhur ndërmjet të ndjerit A.Xh dhe KBI “P” nga Prizreni, e legalizuar nga ana e Gjykatës Komunale në Prizren nën Le.nr. 1380/63 prej 14.09/1963.

Paditësit i propozojnë Gjykatës që pas vlerësimit të fakteve të aprovojë kërkesë padinë dhe të obligojë të paditurën NSH. K “P” që paditësve t’ua dorëzojë në posedim , regjistrim dhe shfrytëzim të lirë ngastrat e cekura më lartë, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së Aktgjykimit me kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

Padisë i bashkëngjiten, Aktgjykimit të Gjykatës Komunale, Prizren, P.nr.471/94 të datës 13/02/1997, Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut Prizren Gz. Nr. 435/97 të datës 25/04/1997, Certifikatën e vdekjes së A. (I) Xh, Certifikatën e lindjes së Sh. Xh , R. Xh dhe R1 Xh

Certifikatën pronësorë nr. 00571-2 dhe nr. 00568-2, Certifikatën e vdekjes së S. Xh dhe Certifikatën e lindjes së Xh. Xh.

Me datë 24.04.2010 pala paditëse, me parashtrësë, e ka plotësuar padinë në kuptimin subjektiv, ashtu që si paditës emëruan edhe Xh. R .

Me datë 19.01.2011, Gjykata Komunale në Prizren, lëshoi Aktgjykimin me nr C.nr.326/01, me të cilin miratoi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësve Sh Xh ,R Xh, R1 Xh,S Xh dhe Gj Xh , të gjithë nga , Prizren, në bazë të trashëgimisë, pas vdekjes së babait A. Xh marrin secili nga 1/5 e pjesëve ideale në patundshmëri dhe atë:

-par. Kad. Nr. 568/2, vendi i quajtur R , në sipërfaqe prej 2559 m², në matjet dhe kufijtë: nga veriu 75.16m, nga jugu 87,04m, nga lindja 40,72m dhe nga perëndimi 23,53 m, dhe -par. Kad. Nr. 571/2, vendi i quajtur “R”, në sipërfaqe prej 1832m², në matjet dhe kufijtë: nga veriu 56,94m, nga jugu 51,61m, nga lindja 39,21m, dhe nga perëndimi 34,61m, të dyja të evidentuara sipas listës poseduese me nr. 59 ZK, L.

Gjykata obligon të paditurën që paditësve t’ua dorëzojë në shfrytëzim dhe posedim të lirë lëndët e patundshmërisë, si dhe të mundësojë që paditësit në patundshmëritë e lartë cekura, të regjistrohen si bashkëpronarë, secili nga 1/5 të pjesëve ideale, në Zyrën Kadastrale të Komunës së Prizrenit , në të kundërtën regjistrimi do të kryhet në bazë të këtij Aktgjykimi, të gjitha këto në afat 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

Aktgjykimi, C. Nr. 326/01, të datës 19.01.2011 sipas fletë kthesës, KBI “P” i servohet me datën 20/04/2011 ndërsa AKP-së më datën 20/04/2011.

Me datë 03.05.2011, e paditura KBI “P” Prizren paraqet ankesë (më tutje ankues i parë), në Gjykatën Komunale Prizren për Gjykatën e Qarkut në Prizren, kundër Aktgjykimit me nr. C. Nr. 326/01, të datës 19.01.2011 (më tutje Aktgjykimi i ankimuar) për shkak të shkeljeve esenciale të procedurës, për aplikim të gabuar të ligjit dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke propozuar që Gjykata të bëjë ndryshimin e Aktvendimit të ankimuar, dhe ta kthejë lëndën për rishqyrtim dhe rivendosje, në Gjykatën e Shkallës së parë.

Me datë 03.05.2011, AKP-ja dorëzon ankesë (më tutje ankues i dytë), në Gjykatën Komunale në Prizren për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme në Prishtinë, kundër Aktgjykimit nr. C.nr.326/2001 të datës 19/01/2011, (më tutje Aktgjykimi i ankimuar) me bazë juridike dorëzimi në posedim. AKP-ja e kundërshton në tërësi Aktgjykimin e ankimuar, me arsyetimin se është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave procedurale dhe me aplikim të gabuar të dispozitave materiale, duke shtuar se Gjykata në Aktgjykim nuk ka dhënë fare arsyet juridike dhe bazën ligjore mbi të cilin e mbështet diapozitivin e Aktgjykimit si dhe pretendon se Gjykata nuk është kujdesur zyrtarisht për legjitimitetit aktiv të paditësve në procedurë, duke pretenduar se paditësit nuk i kanë ofruar gjykatës, Aktvendimin e Trashëgimisë si provë e vetme që argumenton se kush janë trashëgimtarë.

Tutje AKP-ja vlerëson se vendosja në këtë çështje juridike bie ndesh me parimin Res Judicata, pasi që lidhur me rastin C.nr.471/94, me datë 25.04.1997, Gjykata Komunale në Prizren ka vendosur një herë. Andaj nga se u tha më lartë AKP-ja potencon se Aktgjykimi në fjalë është i pa bazuar në ligj.

Në gjykatën e Qarkut , Prizren lënda evidentohet me nr. Ac.nr.173/2011.

Me datë 28.08.2011, DHPGJS-së pranon shkresat e lëndës AC.nr.173/2011 dhe lëndës C.nr.326/01, nga Gjykata e Qarkut në Prizren.

Me datë 25.08.2011 Kolegji i Specializuar pranon juridiksionin mbi lenden ne fjalë dhe njëkohësisht dërgon lenden në Kolegjin e Apelit për shqyrtim.

Në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së, lënda evidentohet si AC-II-15-0027.

Ankesat e të paditurave u janë dorëzuar paditësve me datën 12/03/2020. Nuk është parashtrua pergjigje ndaj ankesave.

Arsyvetimi ligjor:

Ankesat janë të bazuara.

Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës sipas nenit 69.1 të Shtojcës së Ligjit nr.06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Juridiksioni i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme është i rregulluar me nenin 5 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Padia është parashtruar në Gjykatën Komunale të Prizrenit me 08/06/2001, do të thotë para datës së hyrjes në fuqi të Rregullores së UNMIK-ut 2002/13 dhe 2008/4 lidhur me themelimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, paraardhëses së DHPGJS-së. Padia , po ashtu është parashtruar shumë kohë para datës së hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 03/L-033 mbi DHPGJS-në (LDHP) dhe Shtojcës së tij, i cili ka hyrë në fuqi me 1 janar 2012 si LDHP nr. 06/L-086 më 12 korrik 2019.

Një ndër parimet e LDHP-së është juridiksioni ekskluziv i DHPGJS-së për lëndët e përshkuara me ligj. Në bazë të Nenit 5, paragrafi 1.1.4 të LDHP-së, DHPGJS-ja ka, midis tjerash, edhe juridiksion ekskluziv për të gjitha paditë kundër ndonjë ndërmarrje apo korporate që thuhet se është ngritur gjatë apo para periudhës kur ndërmarrja apo korporata e tillë është apo ka iu ka nënshtruar autoritetit administrativ të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit apo Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Në bazë të Nenit 5, paragrafi 7 të LDHP-së, asnjë gjykatë në Kosovë, pos DHPGJS-së nuk do të ketë juridiksion për asnjë padi të përshkruar në paragrafin 1 të këtij Neni, pos nëse parashikohet në mënyrë specifike në paragrafin 3, të cilat lëndë këtu nuk kanë ndonjë lidhje.

Nëse ndonjë gjykatë ka ushtruar apo ka provuar të ushtrojë juridiksion për ndonjë padi e cila është në juridiksionin e DHPGJS-së, çdo Aktgjykim apo Aktvendim i lëshuar nga gjykata e tillë lidhur me atë padi, si pas ligjit, është e pavlerë dhe e pa përmbarueshme dhe se DHPGJS-ja , me kërkesë të ndonjë personi apo me nismë të saj, do të lëshojë një urdhër për atë qëllim. DHPGJS-ja, po ashtu, do të urdhëroj, me kërkesë të ndonjë personi apo me nismë të saj, gjykatën përkatëse që ta bartë atë lëndë në DHPGJS.

Gjykata Komunale në Prizren me Aktgjykimin e ankimuar paditësve ua aprovon kërkesë padinë e tyre dhe e detyron të paditurën që të pranojë që parcelat –ngasrat kadastrale, lëndore nga Aktgjykimi i ankiamuar të regjistrohen në librat e zyrës kadastrale në emër të paditësve.

Aktgjykimi i ankimuar i Gjykatës Komunale në Prizren ishte nxjerrë me datë 19/01/2011 dhe nuk është i plotëfuqishëm, pasi që është i ankimuar.

Në këto rrethana të sqaruara të këtyre fakteve, çështje esenciale është nëse Gjykata Komunale në Prizren kishte juridiksion lidhur me padinë, dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit është se ka munguar juridiksioni i kësaj Gjykate për të vendosur lidhur me padinë e palëve të përfshira në kontest.

DHPGJS nxjerr përfundimin se qëllimi i LDHP-së është që t'i mbledh lëndët që janë nën juridiksionin e saj në DHPGJS për ti gjykuar. Ligji ka efekt prapaveprues për atë sa i përket juridiksionit. Edhe në bazë të LDHP-së Gjykata Komunale në Prizren nuk ka pasur juridiksion për këtë lëndë dhe se juridiksioni ekskluziv për këtë lëndë e ka DHPGJS-ja. Palë e paditur është KBI "P" L në Prizren, do të thotë një NSH e administruar nga AKP-ja. Pronat e kontestuara që ishin lëndë e kontratave të anuluar me Aktgjykimin e ankimuar, aktualisht janë në emër të paditurës.

Në kushte të këtilla lidhur me padinë e paditësve e cila është paraqitur me 08/06/2001, Gjykata Komunale në Prizren fillimisht ka pas juridiksion mirëpo pas themelimit të DHPGJS-së me Rregulloren e UNMIK-ut 2002/13 e ndryshuar me Rregulloren nr. 2008/4, që nga 13 qershori i vitit 2002 asnjëherë nuk ka pasur kompetencë për padinë e paditësve, pasi që lidhur me padinë e drejtuar ndaj një NSH-je vetëm DHPGJS-ja ka juridiksion ekskluziv.

Kjo gjykatë ka qenë e obliguar që në bazë të nenit 17, paragrafi 1 i LPK-së, ex officio të trajtoj nëse është kompetente për të gjykuar rastin e parashtruar para saj ose jo. Në këtë mënyrë, në zbatimin e procedurave gjatë vendimmarrjes, kjo gjykatë ka marrë Aktgjykimin e kundërshtuar, me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore.

Për arsyet e lartpërmendura, Kolegji i Apelit, nuk mund të vërtetoj asnjë vendim me shkelje të tilla procedurale, andaj është e obliguar që t'i (anuloj)shpallë Aktgjykimin e ankimuar pa efekt juridik.

Në bazë të nenit 5, paragrafi 3 i LDHGJS-së, as Dhoma e Posaçme e as Kolegjet apo gjyqtarët e saj, nuk do të kenë asnjë autoritet, për t'i referuar ndonjë kërkesë, lëndë, procedurë, apo rast specifik që është kompetencë ekskluzive e tyre, tek gjykatat e tjera në Kosovë.

Për këtë arsye, duke mos paragjykuar epilogun përfundimtar të kësaj padie, Kolegji i Apelit lëndën e dërgon në gjykim në shkallë të parë të DHPGJS-së për gjykim.

Andaj konform nenit 9.10 të LDHPGJS-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Taksat gjyqësore:

Nuk caktohen taksat gjyqësore për procedurën ankimore, sepse plani i miratuar i taksave gjyqësore të DHPGJS-së, i cili ka hyrë në fuqi më 27 mars 2014, nuk mund të zbatohet në mënyrë retroaktive për lëndët në pritje.

U vendos nga Kolegji i Ankesave në DHPGJS, më 16/07/ 2020

Ilmi Bajrami, Gjyqtar Kryesues
